



**BANKA E SHQIPËRISË**

**Si prodhohet një  
kartëmonedhë shqiptare?!**

## Si prodhohet një kartëmonedhë shqiptare?!

**A KENI QENË NDOJËHERË KURESHTARË TË DINI SE SI PRODHOHEN KARTËMONEDHAT QË PËRDORIM ÇDO DITË?**

**DO T'JUA ILËSTROJMË HAP PAS HAPI KËTË PROCES NËPËRMJET SHEMBULLIT TË KARTËMONEDHËS 2000 LEKË.**

Krijimi i një kartëmonedhe të re është një proces kompleks dhe i vështirë, i cili kërkon përbushjen e disa qëllimeve të ndryshme dhe shpesh të kundërta. Kjo sepse një kartëmonedhë përfaqëson kryesisht një mjet pagese por edhe një vepër arti. Përgjithësisht projektimi dhe prodhimi i kartëmonedhave kërkojnë studime të thelluara. Portretet dhe simbolet kombëtare kanë qenë, tradicionalisht, elementet kryesore të dizenjimit të tyre. Përvoja ka treguar se publiku mund të dallojë më lehtësisht kartëmonedhat e falsifikuara, kur elementet e dizenuara në to janë portrete.



## 1. Përzgjedhja e tematikës dhe dizenjimi

Ka qasje të ndryshme të cilat mund të ndiqen për dizenjimin e kartëmonedhave. Shpjegimi i mëposhtëm përshkruan procesin e miratuar për dizenjimin e kartëmonedhave shqiptare të qarkullimit, apo si njihen në një gjuhë më teknike, kartëmonedhat me kurs ligjor.


Banka e Shqipërisë ka të drejtën ekskluzive të prodhimit të kartëmonedhave kombëtare shqiptare dhe kjo përfshin edhe dizenjimin e tyre. Por nuk duhet të harrojmë se kartëmonedhat janë në shërbim të të gjithë qytetarëve dhe si të tilla ato duhet të pasqyrojnë vlera kombëtare.

Për këtë arsye, Banka e Shqipërisë krijon një grup të veçantë pune që merret me studimin e tematikës që do të pasqyrohet në një kartëmonedhë të re. E thënë më thjesht ajo ndihmohet nga një panel këshilltarësh të institucioneve të ndryshme të vendit. Në përcaktimin e tematikave, Banka e Shqipërisë, në bashkëpunim me konsulentët e jashtëm, e përdor mundësinë e krijimit të një kartëmonedhe të re edhe për të nderuar personalitete të historisë së vendit, të cilët në periudha të ndryshme historike kanë dhënë një kontribut të rëndësishëm për Shqipërinë. Dizenjimi i kartëmonedhës, krahas portretit të personit, përfshin edhe elemente të tjera stilistike, të cilat lidhen me arritje të veçanta të figurës historike të portretizuar.

Për të kuptuar se si realizohet ky hap i krijimit të një kartëmonedhe të re, po përshkruajmë shkurtimisht rastin e kartëmonedhës 2000 Lekë. Për përcaktimin e tematikës që do të mbante kjo kartëmonedhë, Banka e Shqipërisë ngriti një grup me qëllim studimin e tematikës. Ai përbëhej nga përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, të Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë, të Institutit të Historisë, të Seksionit të Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike të Akademisë së Shkencave, të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të Ministrisë së Integritimit Evropian, të Postës Shqiptare dhe të Lidhjes së Shkrimtarëve Shqiptarë.

Pas diskutimeve, ky grup arriti në përfundimin se kartëmonedhat e asaj kohe, përfaqësonin periudha të ndryshme të historisë së popullit shqiptar, por nuk përfshinin periudhën ilire.

Pas përcaktimit të tematikës, Banka e Shqipërisë shpall një konkurs publik për të përzgjedhur vizatimin më të mirë që do të paraqesë tematikën e përzgjedhur.




Periudha ilire nuk ka qenë e përfaqësuar në serinë e kartëmonedhave shqiptare përpara emetimit të kartëmonedhës 2000 Lekë. Si figurë u përzgjedh Mbreti Gent, pasi ky i fundit njihet nga historia si prerës i monedhës ilire dhe si zbulues i vetive kuruese të bimës Gentiana, emërtimi i së cilës vjen pikërisht nga emri i tij.

Artistët janë të lirë ta punojnë vizatimin sipas dëshirës: me dorë, kompjuter, me laps, me bojëra, etj.

Komisioni për vlerësimin e vizatimit më të mirë për kartëmonedhën 2000 Lekë kishte në përbërje të tij përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, Akademisë së Arteve dhe të Institutit të Historisë.

Të mos harrojmë se dizënjimi i një kartëmonedhe ka veçori teknike, të cilat nuk i lejojnë artistit të ketë “një dorë plotësisht të lirë”. Banka e Shqipërisë vendos disa kufizime teknike që kanë të bëjnë me vendosjen e elementeve të sigurisë në kartëmonedhë.

Gjithashtu, çdo kartëmonedhë duhet të ketë një ngjyrë dominuese me qëllim që të dallohet lehtësisht nga kartëmonedhat e tjera.



Me një lastër mund të  
printohen 18 kartëmonedha  
2000 lekë në një  
fletë të vetme.

## 2. Përgatitja e lastrës

Siç e thamë edhe më parë kartëmonedhat janë mjete pagese. Si të tilla, ato duhet të kenë elemente sigurie shumë të larta, për të shmangur sa më shumë procesin e falsifikimit të saj. Rrjedhimisht dhe printimi i kartëmonedhave kryhet nga kompani të specializuara në këtë fushë.

Printimi i kartëmonedhës është një proces i ndërlikuar dhe me shumë hapa. Puna për printimin e kartëmonedhës fillon me gdhendjen me dorë të vizatimit të kartëmonedhës në një pllakë të veçantë metalike. Nga kjo pllakë prodhohet një pllakë më e madhe, që quhet lastër. Lastra mundëson printimin e disa kartëmonedhave së bashku në një tabak të vetëm letre. Ky është një proces që kërkon shumë punë, rregullime dhe përmirësime të njëpasnjëshme për të përmbushur një nivel të lartë saktësie, tonalitet të gjerë ngjyrash dhe kërkesat përkatëse për printimin e kartëmonedhës.



### 3. Printimi i kartëmonedhës

Kartëmonedhat printohen në një letër të veçantë që prodhohet nga pambuku. Kjo lloj letre dallohet për qëndrueshmërinë e saj të lartë. Gjatë procesit të përgatitjes së letrës, integrohen në të filli i sigurisë dhe filigrama. Këto janë elementet e para të sigurisë që duhet të kërkon në kartëmonedhë për t'u siguruar për vërtetësinë e saj!



Printimi i kartëmonedhës është një proces mjaft teknik, për të cilin është e vështirë të flitet thjesht. Shkurtimisht ai mund të ndahet në këto tri procese kryesore:

1. Printimi me transfertë (me gjuhë teknike *offset*). Quket kështu pasi boja nuk printohet drejt e në letër, por nëpërmjet një mekanizmi me bobina rotulluese, në mes të të cilit është vendosur lastra, transferohet boja nga një bobinë te tjetra dhe kështu realizohet në letër printimi i pamjes kryesore të anës së përparme dhe të pasme të kartëmonedhës.
2. Shtypi i thellë (me gjuhë teknike *intaglio*). Ky proces realizon pjesët me relief të kartëmonedhës të cilat mund t'i dalloni shumë lehtë nëse prekni kartëmonedhën në pjesën ku shkruhet 2000 Lekë dhe portretin e Mbretit Gent.
3. Letërshtypje. Mundëson vendosjen e numrave serialë dhe të firmave. Siç e dini çdo kartëmonedhë ka një numër serial të veçantë dhe përmban dy firma: atë të Guvernatorit dhe atë të Drejtorit të Departamentit të Emisionit të Bankës së Shqipërisë.

Midis këtyre proceseve, kuptohet ka dhe procese të tjera të vogla si: printimi me vulë të nxehtë i hologramës apo printimi i bojës së ndryshueshme në të ashtuquajturit ekranë “mëndafshi”, që e kanë marrë këtë emër për shkak të trashësisë së tyre. Të gjitha këto procese së bashku mundësojnë integrimin e plotë të elementeve të sigurisë në një kartëmonedhë.




Gjithashtu, në kartëmonedhë vendosen dhe disa shenja të veçanta për të verbrit, në mënyrë që ata të kenë mundësi të dallojnë vlerën e kartëmonedhës.





## 4. Prerja dhe paketimi


Kartëmonedhat e printuara në tabakë të mëdhenj letre janë gati për t'u prerë. Por përpara prerjes, ato i nënshtrohen një inspektimi, numërimi dhe verifikimi të rreptë, i cili përbën një pikë shumë të rëndësishme në gjithë procesin e printimit të kartëmonedhës. Vetëm tabakët që plotësojnë 100% kushtet e cilësisë kalojnë në prerje. Pas prerjes, kartëmonedhat kalojnë në një proces tjetër, i cili ka të bëjë me kontrollin e cilësisë milimetrike të përmasave të kartëmonedhës. Pas këtij kontrolli të fundit, kartëmonedhat paktohen në pako 1000 copëshe.



## 5. Hedhja në qarkullim

Megjithëse janë printuar, kjo nuk do të thotë se kartëmonedhat e reja mund të fillojnë të qarkullojnë, pra të vijnë në dorën tonë për të kryer blerje.

Më parë kartëmonedhat e printuara duhet të transportohen nga mjediset e kompanisë prodhuese, e cila gjendet jashtë vendit, në Bankën e Shqipërisë. Ku kontrollohet dhe njëherë. Pas kontrollit, kartëmonedhat vihen në qarkullim në bazë të një vendimi të posaçëm të Bankës së Shqipërisë, shoqëruar me një fushatë informuese për publikun.



Në 29 dhjetor 2008, hyri për herë të parë në qarkullim kartëmonedha 2000 Lekë.



**NËSE JENI TË INTERESUAR TË MËSONI SE SI QARKULLOJNË PRAKTIKISHT KARTËMONEDHAT SHFLETONI FLETËPALOSJEN “RRUGËTIMI I PARASË”.**

**TANI QË MËSUAT GJITHË PROCESIN E KRIJIMIT TË NJË KARTËMONEDHE, E KUPTONI SE SA E RËNDËSISHME ËSHTË MIRËEMBAJTJA E TYRE!!!**



[www.bankofalbania.org](http://www.bankofalbania.org)